




Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	29.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCK	8610/2022		119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.774/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2654/2021 t datës 30.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.774/2021 të datës 27.08.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Shaqir Igrishta", Kompleksi Tregtia , Hyjra 12, Nr. 18, Lagja Mati 1, në Prishtinë, kundër Vendimit KA.Nr.11/2021 të datës 04.08.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.774/2021 e datës 27.08.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.11/2021 i datës 04.08.2021 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial.

**A r s y e t i m**

Sekretariati Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 07.05.2021 ka shpallur konkursin me numër Reference: KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-007 për pozitën Zyrtar për Mbrotjtjen dhe Ndihmë Viktimave në Prishtinë, ku në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është përfshirë në të gjitha fazat e procedurës. Pas përfundimit të procedurës, më datë 14.06.2021 është publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm, ku sipas të cilit ankuesja nuk është kandidate e suksesshme.



Ankuesja kundër njoftimit të datës 14.06.2021, më datë 12.07.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit KA.Nr.11/2021 të datës 04.08.2021 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke e vërtetuar njoftimin e datës 14.06.2021.

Ankuesja kundër këtij vendimi më datë 27.08.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4423/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, 30.08.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli Prokurorial të Kosovës. Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 08.09.2021 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankueses, ndërsa më datë 12.10.2021 ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 30.11.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2654/21 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 12.10.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:4423/2022 të datës 27.08.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.Nr.11/2021 të datës 04.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.08.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 08.09.2021; Vendimin KPK/Nr.193/2021 i datës 26.03.2021; Kërkesë për autorizim për publikimin e shpalljeve i datës 31.03.2021; Konkursin e datës 07.05.2021 me numër Reference: KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-007 për pozitën *Zyrtar për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave në Prishtinë*; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar i datës 25.05.2021; Vendimin DPSKPK/Nr.173/2021 i datës 19.05.2021 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Listën e shkurtër e datës 28.05.2021; Deklaratë për mosekzistim të konfliktit të interesit e datës 01.06.2021; Testin me shkrim i datës 01.06.2021 i ankueses dhe kandidatit , Kërkesën për punësim të ankueses e datës 17.05.2021, Diplomën me Nr. 1406 të ankueses, Diplomën me Nr. 2231 për ankuesen, Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për ankuesen e datës 11.05.2021, Kontratë Punë për Kohë të Caktuar e datës 01.01.2017 për ankuesen, Certifikatë për kryerjen e stazhit të praktikës e datës 12.11.2018, Vërtetimin me Nr. 382/2015 i datës 27.03.2015, Letër Rekomandim për ankuesen i datës 06.07.2015, Referencë e datës 02.10.2020 nga AL-BER për ankuesen, Pasqyrë nga TRUSTI për ankuesen, Dokument identifikimin për ankuesen; Kërkesën për punësim të kandidat e datës 20.05.2021, Diplomën me Nr. 2855 për , Diplomën me Nr. 1871 për Marrëveshje për shërbime të

Veçanta e datës 17.07.2019, 02.11.2018, 07.02.2018, Akt Emërimin e datës 18.10.2016, Certifikatë Nr. Ref: DS-015/2017 e datës 25.10.2017, Letër Reference për datës 04.08.2017, 26.04.2019, Certifikatën e datës 05.02.2010, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 25.02.2021 për Dokument identifikimi për Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare i datës 14.06.2021; Formularin e përmbledhjes së vlerësimeve individuale i datës 10.06.2021; Ankesën e datës 12.07.2021 të ankueses; Njoftimin me Nr. Prot: 4996/2021 i datës 12.10.2021; Aktgjykimin A.nr.2654/2-21 i datës 30.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.11/2021 të datës 04.08.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial, pretendon që nuk është njoftuar për rezultatin përfundimtar përveç që në njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 14.06.2021 janë publikuar vetëm pikët për këtë kandidat.

Bazuar në provat e lëndës, respektivisht përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe me gojë, del se ankuesja është vlerësuar me 328 pikë apo 65.6% të pikëve dhe është renditura e treta, ndërsa kandidati është vlerësuar me 409.5 pikë apo 81.9%, ndërsa gjatë shqyrtimit të çelësit të testit me shkrim dhe me gojë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil testin me shkrim dhe me gojë për kandidatët e ka vlerësuar në pajtim me nenin 37 dhe 39 të Rregullores Nr.02, 2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu në bazë të provave të lëndës, nuk është vërejtur ndonjë shkelje procedurale gjatë vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë sepse të gjithë kandidatëve i është dhënë mundësia e barabartë për t'iu nënshtruar të gjitha procedurave ligjore, në këtë rast Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Në bazë të konkursit të shpallur për pozitën Zyrtar për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave në Prishtinë kriteret kanë qenë të përcaktuar "Diplomë universitare, Fakulteti Juridik dhe Një vit përvojë pune profesionale", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se kandidatët e përzgjedhur si dhe ankuesi, kanë plotësuar kushtet e konkursit, si rrjedhojë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin përfshirjes së tyre në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: "1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë:1.1 Arsimimi dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës".

Bazuar në të gjitha të lartcekurat, Kolegji i Këshillit konstaton se në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërim më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë", po ashtu Kolegji, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën

Zyrtar për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave në Prishtinë është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse ankueses nuk i është cenuar asnjë e drejtë në këtë proces, siç pretendon e njëjta, rrjedhimisht Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës me rastin e zhvillimit të kësaj procedurë ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.Nr.11/2021 të datës 04.08.2022, gjatë shqyrtimit të ankesës ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi sepse ka shqyrtuar drejtë pretendimet ankimore, duke e arsyetuar të njëjtit në pajtim me dispozitat e nenit 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.774/2021**

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Procesmbajtës

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

*Malsore Gashi*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së